



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Qershor, 2021
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Muhamet Pervetica, u.d. i udhëheqësit të Sektorit të shëndetësisë në DSH, Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi në DSH.

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes, ecurisë së punës në drejtorinë tuaj, për muajin raportues.

Gjatë muajit qershor 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 132 lëndë, nga të cilat 115 ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore, kurse 17 të tjera ishin të kategorive të ndryshme.

Stafi në këtë drejtori kishte takime të përditshme më qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe më shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planprokurimit 2021;

- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

Përfundojnë specifikat për të kaluar në proces të njoftimit për kontratë:

- Furnizim emergjent me insulina për nevojat e QKMF-së;
- Furnizim me material shpenzues mjekësor;
- Furnizimi me material shpenzues për shërbime laboratorike- Furnizimi me reagensë për numërues hematologjik ADVIA 560 5 - Loto 3;
- Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e kujdesit primar shëndetësor QKMF dhe QMU;
- Furnizimi me uniforma për personelin shëndetësor në QKMF dhe QMU;
- Digjitalizimi i laboratorëve shëndetësorë;

Ndërkaq, njoftohet për dhënie kontrate aktiviteti - Furnizimi me material shpenzues për shërbime laboratorike dhe stomatologjike;

Çdo kërkesë nga ofertuesit u sqarua profesionalisht nga njësia kërkuese;

Përgjatë periudhës raportuese vazhduan punimet rreth përmirësimit të infrastrukturës në objektet e QMF-së 4 dhe AMF-së në Bardhoshë;

Ndërkaq inventarizimi fillon në QMF 5 dhe AMF Bardhosh;

- Dezinsektimi hapësinor në komunën e Prishtinës, faza e parë filloi më 14.06.2021, përderisa gjatë muajit qershor fillon edhe faza e dytë, më 28.06.2021;

Pas përcaktimit të listës së ngushtë dhe afatit ligjor, testohen dhe fillojnë të

intervistohen kandidatët bazuar në pozitat e lira të personelit shëndetësor në QKMF dhe QMU;

Por, në ndërkohë anulohen dhe rishpallet konkursi për pozitat e lira spec. i MF, radiologjisë dhe biokimisë;

QMF 11 furnizohet me kontejnerë përmes bashkëpunimit të DSHPMSH;

DSH ishte pjesëmarrëse në takimin online - Seancë informuese e Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Përgatitja e specifikave bazuar në plan prokurimi 2021;
- Mbikëqyrje të vazhdueshme të punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;

- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Fondi Burimor	Planifikuara	Alokuara	Shpenzuara	Nr. lëndëve
Pagat	7,570,000	504,155.36	504,155.36	
Mallra dhe shërbime				
10	1,294,300.00	647,150.02	4,079.39	11
21	400,000.00	129,515.00	1,816.54	7
4	771,740.00	771,740.00	33,926.00	45
Komunali				
	300,000.00	150,000.00	7,817.81	26
Kapitale				
21	1,600,000.00	1,000,000.00		
22	1,211,377.00	1,211,377.49	53,278.76	2
Subvencione				
	150,000	150,000.00	29,950.00	157
Gjithsej				248

Raport - deklaram të borxheve më të vjetra se 30 ditë;

Deklarimi për ATK-në ;

Raport mujor, shpenzimet e realizuara dhe për të hyrat nga bashkëpagesat për shërbime shëndetësore;

Pranim të faturave dhe arkivimi i tyre;

Përgatitja e dokumenteve të nevojshme për procedim të mëtutjeshëm;

Zotimi ;

Dërgimi i lëndëve për procedim të mëtutjeshëm në prokurim dhe Financa;

Përgatitja e deklaratave të disponueshmërisë për procedura të prokurimit;
Më 10.06.2021, është mbajtur komision për shqyrtimin e kërkesave, trajtim mjekësor;

* Shqyrtuar gjithësej kërkesat;

* Të miratuara 165 kërkesa;

Raport mujor për Ministrin e Shëndetësisë rreth shpenzimeve për Fondin e huamarrjes.

5.1.2. Takimet me palë

- Çdo dite nga ora 9:00 deri në orën 15:00, DSH bën pranimin e palëve;

5.1.3. Takimet me institucione tjera;

- Drejtoria e Investimeve Kapitale:
 - o Menaxhim i kontratës “ Renovime dhe rindërtime”;
- Drejtoria e Prokurimit:
 - o Procedura rreth kontratave të ndryshme;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit:
 - o “Furnizim me kontejnerë mbeturinash” - QMF 11.

5.1.4. Diskutime publike, takime me qytetarë;

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare;

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër;

- 132 lëndë nga të cilat 115 ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore, kurse 17 tjera ishin të kategorive të ndryshme.

5.1.7. Përfitues të subvencioneve:

Gjate muajit qershor, u pranuan 132 lëndë me përmbajtje për subvencionim të problemeve shëndetësore.

Më 10.06.2021, është mbajtur mbledhja e komisionit për shqyrtimin e lëndëve në Drejtorinë e Shëndetësisë, ku janë shqyrtuar gjithsej 165 lëndë, të cilat edhe u miratuan.

5.1.8. Takime të tjera

Drejtori i Shëndetësisë, dr. Bujar Gashi, me qëllim të mbarëvajtjes së punës në Sektorin e shëndetësisë, në mënyrë të vazhdueshme realizoj takime me përfaqësuesit e QKMF-së dhe QMF-së.

Në këto takime drejtori Gashi ka biseduar edhe për vështirësitë që kanë QKMF-të dhe njësitë e saj dhe QMU-të.

Drejtori i Shëndetësisë së Prishtinës në agjendën e tij realizoj takime edhe me nivelin qendrorë, siç është Ministria e Shëndetësisë, me qëllim të informimit dhe rritjes së efikasitetit në Drejtorinë e Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë:

- Mungesa e stafit në DSH;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë "Mallra dhe shërbime", ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Hyrje

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, gjatë muajit qershor 2021, ofroi shërbime shëndetësore urgjente për qytetarët e Prishtinës dhe fshatrave që i takojnë komunës, me ekupe mjekësore dhe autoambulanca.

Patologjia dhe shërbimet

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të urgjencës:

- Hipertension arterial;
- Reaksionet alergjike ;
- Asthma bronchiale;
- Colica abdominale;
- Kokëdhimbjet akute;
- Gastroenterocolitet acute;
- Ataqtet cerebrovasculare;
- Syncopa ;
- Lëndimet nga aksidentet e trafikut;
- Lëndimet në punë, etj.

Edukimi i vazhdueshëm profesional (EVM)

Në kuader të "Edukimit të vazhdueshëm profesional", më 28.06.2021 nga ora 11:00 deri në orën 12:30, për stafin mjekësor është mbajtur ligjerata me temë: Laryngiti acut dhe edema laryngeale, tretmani në kushte paraspitalore.

Furnizimi më medikamente dhe material sanitar

Furnizimi vazhdon nga Ministria e Shëndetësisë - divizioni farmaceutik dhe nga kompanitë e kontraktuara.

Situata me pandeminë COVID-19

Duke përcjellë situatën epidemiologjike gjatë muajit qershor, por edhe nga informatat nga IKSHP-ja, është një gjendje në nivel shtetëror më përmirësime të vazhdueshme sa i përket pandemisë COVID-19.

Gjatë këtij muaj, nuk kishte punëtor të infektuar me COVID-19.

Sipas programit gjatë muajit qershor, shumica e stafit shëndetësor mori dozën e dytë të vaksinës.

Edhe gjatë këtij muaji një ekip mjekësor nga QMU-ja, bëri kujdestari në sallën "1 Tetori" për të ofruar kujdes mjekësor për të gjithë personat të cilët kishin nevojë për kujdes dhe tretman mjekësor.

Nga aktivitet kulturo- sportive

Më 1 qershor, në ndeshjen futbollistike mes Reprerentacionit të Kosovës dhe San Marinos, dy ekiye mjekësore nga QMU-ja asistuan në sigurimin e ndeshjes.

Me organizimin e FASK (Federates se Auto Sporteve të Kosovës) për sezonin 2021 të kampionatit të Kosovës në Auto-Sport, Auto Klubi "Prishtina Racing Team" ka organizuar garat tradicionale në disiplinën kodrinoro-malore në segmentin rrugor Grashticë - Stallovë në gjatësi prej 3 km.

Gara është mbajtur Më datat 12 dhe 13 qershor 2021 prej orës 11:30 deri në orën 15:00.

Me daten 12 qershor më rastin e çlirimit të Kryeqytetit është mbajtur një garë e Ciklistëve prej orës 11:00 deri në orën 12:30 këtë event e ka siguruar ekipi mjekësor i QMU-së.

Me datat 16, 17 dhe 18 qershor prej orës 16:00 deri në orën 19:30 në fshatin Hajvali është mbajtur turniri i futbollit në nivel vendi për kategorit e reja U17.

RAPORTI I PËRMBLEDHUR PËR MUAJIN QERSHOR I KORDINATORËS SË SISH -it QMU

Nr.	Lloji i shërbimit	Nr.
1	Vizita mjekësore në terren	1288
2	Reanimime në terren	3
3	Aksidentet trafiku	99
5	Fatekeqesite të tjera	66
6	EKG	4
7	Transporte	278
8	Konstatim vdekjeje	62
9	Gjithsej	1800

ZYRA E PROKURIMIT NË QMU RAPORT PËR (muajin qershor) 2021

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:**

- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësitë kërkuese;
- Bashkëpunimi i Zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në Komunë dhe bashkëpunimi sipas UA, 2016 të LPP me AQP për kycje në kontratat e centralizuara;
- Sipas LPB-së, bashkëpunimi me drejtorin e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi, protokollimi për vlerësimin e ofertave, pranimit të mallrave ,shërbimeve, caktimin e menaxhereve të kontratave etj.;
- Sipas nevojave të paraqitura.

❖ **AKTIVITETET E ZBATUARA**

- Nxjerrja e urdhër-blerjeve në sistemin e FREE BALANCIT për të gjitha faturat për kontratat që lidhen në QMU dhe faturat e kontratave të AQP-së të cilat i shfrytëzon QMU-ja;
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për furnizim me ujë për pije dhe përgatitja për pagesë;
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për shërbime të fotokopjes dhe printerëve me qira dhe përgatitja për pagesë;
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për furnizim me goma verore dhe përgatitja për pagesë;

- Pranimi i të gjitha faturave tjera që kanë hyrë në QMU dhe përgatitja e tyre për pagesë;
- Përgatitja e dosjes së tenderit për Furnizim me barna dhe material medicinal, publikimi, hapja njoftimi i OE për hapje, dhe anulimi i procedurës;
- Përgatitja e dosjes së tenderit për Furnizim me barna dhe material medicinal-ri tender, publikimi.

❖ **AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR**

- Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës.

- **ZYRA E FINANCAVE NË QMU**

RAPORT PËR (muajin qershor)2021

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:**

- Mbajtja e një takimi me stafin udhëheqës ne lidhje me furnizimet dhe shpenzimet që janë realizuar gjatë muajve paraprak tremujori i dytë.

❖ **AKTIVITETE TË PËRFUNDUARA**

- Përgatitja e lëndëve të poshtë shënuara për pagesë dhe fotokopjimi i tyre;
- Shpenzimet e telefonit për muajin maj;
- Shpenzimet e tel. në ambulancën në rr. "Xhemajl Ibishi" për muajin maj;
- Mbushje telefonike për punëtorë për muajin maj;
- Furnizim me ujë për pije për muajin maj;
- Shfrytëzimi i automjetit me qira për muajin maj;
- Furnizim me karburante për muajin maj;
- Përgatitja e faturave për mirëmbajtjen e autoambulancave;
- Ndërrimet e natës për muajin maj;
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të lehonisë, largime nga puna etj., për muajin maj;
- Përgatitja e pagave për 6 punëtorët me kontrata për punë specifike për muajin maj.

❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPËR:**

- Faturat të cilat duhet të përgatiten për pagesë;
- Fatura e rrymës;
- Sigurimi i autoambulancave;
- Mirëmbajtja e fotokopjes me qira dhe printerëve;
- Mbushje për punëtor për muajin qershor;
- Përgatitja e ndërrimeve për muajin qershor;

- Përgatitja e faturave komunale (rrymë ngrohje, PTK) të cilat janë të rregullta së bashku me faturat e karburanteve dhe automjetit me qira, si dhe pagesat dhe shërbimet tjera.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

RRJEDHA E PUNËS

- Vazhdoj organizimi i brendshëm përshtatur me situatën epidemiologjike, mbi ofrimin e shërbimeve shëndetësore:
 - o Tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) kanë vazhduar punën pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 deri në orën 13:30; 13:30 deri në orën 20:00 dhe 19:00 deri në orën 07:00);
 - o Të gjitha qendrat e mjekësisë familjare punuan sipas orarit të rregullt (07:00 deri në orën 13:30, 13:30 deri në orën 20:00);
 - o Në të gjitha qendrat e Mjekësisë Familjare kujdestaria e rregullt mujore, e shtunë (07:00 deri në orën 19:00) dhe e diele (07:00 deri në orën 13:00);
 - Në QMF 7 vazhdoi ofrimi edhe testi rapid antigjenik për qytetarët e Prishtinës, u punuan 528 teste, përderisa në QKMF edhe analiza e D-dimerit u realizuan 1167 D-dimera, që të dyja këto falas, poashtu janë punuar edhe testet serologjike 265 pacientë të testuar me teste serologjike;
 - Gjithësej teste janë punuar 530 d.m.th. 265 IgG dhe 265 IgM;
 - Numri i pacientëve me COVID-19 pozitiv, të cilët kërkuan trajtim parenteral në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare, arriti në 214 pacient;
 - Gjatë periudhës raportuese u ofruan 284 konsulte virtuale;
 - o QMF Besi, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30 13:30 deri në orën 20:00) organizohet dhe kujdestaria e rregullt mujore, e shtunë (07:00 deri në 19:00) dhe e diele (07:00 deri në orën 13:00), AMF Bardhosh nga data 05.05.2021, është në renovim, AMF Barilevë, nuk punon, AMF-së Sharban dhe Rimanishtë orari i punës (07:00 deri në orën 14:00);
 - Llukar, orari i punës (07:00 deri në orën14:00), AMF Keqekollë, orari i punës (08:00 deri në orën 14:00), të martave nuk punohet, AMF Koliq, punohet të martave nga ora (08:00 deri në 14:00), AMF Dabishevc, punohet të enjteve nga ora (10:00 deri në orën 12:00);
 - o AMF Mramor, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30) çdo ditë, AMF Slivovë, Viti, Bullaj nuk punohet, AMF Kishnicë, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30);
 - o AMF Shkabaj, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30);
 -
 - o Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik, orari i punës(07:00 deri në orën 15:00), shërbimi i stomatologjisë në QMF 5 punon 24/7;

- Shërbimi pediatrik, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30 dhe 13:30 deri në orën 20:00);
- QMG, orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
- Shërbimi specialistik, orari i punës (07:00 deri në orën15:00);
- Mjekësia e punës, orari i punës (07:00 deri në orën15:00);
- DAT, orari i punës (07:00 deri në orën13:00);
- Laboratori qendror, orari i punës (07:00 deri në orën14:00 -13:00 deri në orën 20:00);
- Radiologjia, orari i punës (07:00 deri në orën 13:00), tri njësi radiologjike në QKMF, QMF4, QMF 5.
- Shërbimi i vaksinimit orari i punës (08:00deri në orën 16:00), orari është përshtatur për arsye pjese më e madhe e punëtorëve shëndetësorë nga data 29.03.2021, janë duke kontribuar në sallën “1 Tetori” rreth vaksinimit të qytetarëve kundër COVID-19 ;

Janë duke funksionuar 30 ekipe të vaksinimit, në orarin paradite 15 dhe 15 ekipe të vaksinimit në orarin e pasdites;

Numri i të vaksinuarve për qershor është 21.047 dhe numri total i të vaksinuarve nga data 29.03.2021 deri më 30.06.2021 është 85.068;

-Numri i stafit të infektuar gjatë muajit qershor, nuk ka asnjë të infektuar;

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare (ndërrimi i paradites, pasdites dhe ndërrimi i natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze;

- Respektohen rregullat e përgjithshme, furnizimi qëndron mirë, masat mbrojtëse aplikohen.

Vizita mjekësore	Shërbimet shëndetësore	Shërbimet laboratorike	Shërbimet stomatologjike	Shërbimet radiologjike	Gjithsej
490432	500653	453184	73302	17315	1534886